



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 167

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 23 nëntor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 116/2018, datë 22.11.2018	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Brendshëm..... 11291
Dekret i Presidentit nr. 10959, datë 20.11.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11291
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 34, datë 16.11.2018	Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare..... 11291
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 310, datë 15.11. 2018	Për delegimin e kompetencave..... 11292
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9801/5, datë 20.11.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës “Xoxi Andoni” dhe hapësirave rreth saj””, shtesa, Fier..... 11292
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Hysen Sadik Shehu... 11293

**VENDIM**
Nr. 116/2018**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË**
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E MINISTRIT TË
BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 10 957, datë 16.11.2018, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 10 957, datë 16.11.2018, për emërimin e zotit Sandër Lleshaj në detyrën e Ministrit të Brendshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 22.11.2018

DEKRET
Nr. 10959, datë 20.11.2018**PËR DHËNIE TË SHKETËSISË**
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Shyqiri Qerim Bytyqi
2. Shaha Sejdi Bytyqi (Makolli)
3. Baton Minir Dushi
4. Artizane Emin Dushi (Shkodra)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 34, datë 16.11.2018**PËR NDALIMIN E TELEFONIT**
CELULAR NË INSTITUCIONET
ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26, të ligjit nr.69/2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare është e ndaluar të disponohet telefon celular nga nxënësit dhe mësuesit.

2. Në rast konstatimi të disponimit të telefonit celular nga nxënësit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare, drejtoria e institucionit:

a) Sekuestron telefonin celular dhe zbaton masa disiplinore, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Telefonat e sekuestruar depozitohen pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar;

b) Masat e marra ndaj nxënësit i njoftohen me shkrim prindit ose kujdestarit ligjor të nxënësit.

3. Drejtoritë e institucioneve arsimore:

a) Të rishikojnë rregulloren e brendshme të shkollës, duke përcaktuar masat për ndalimin e telefonit celular nga nxënësit dhe mësuesit, në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare;

b) Të marrin masa për të organizuar takime me prindërit për njohjen me rregulloren e re;

c) Të vendosin në çdo klasë poster për ndalimin e telefonit celular;

d) Të sigurojnë nënshkrimin e deklaratës së përbashkët të mësuesit të klasës me prindin ose kujdestarin ligjor, për ndalimin e marrjes së telefonit celular në mjediset e shkollës nga nxënësit;

e) Të marrin masa për të vënë në dispozicion numër telefoni të veçantë për komunikim me prindërit e nxënësve dhe t’ia bëjnë me dije prindit deklaratën e përbashkët;

f) Të raportojnë me shkrim pranë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, për masat e marra ndaj mësuesit, në rast të përdorimit të telefonit celular gjatë procesit mësimor.

4. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:



a) Të monitorojnë masat e marra nga institucionet arsimore për ndalimin e telefonit celular nga nxënësit dhe mësuesit, në mjediset shkollore;

b) Të depozitojnë pranë Policisë së Shtetit telefonat celular të sekuestruar nga shkollat;

c) Të raportojnë çdo muaj me shkrim në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe drejtoritë e institucioneve arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
Lindita Nikolla

URDHËR

Nr. 310, datë 15.11. 2018

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Erjon Luçi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deleguar sipas pikës 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 15.11.2018 deri më 19.11.2018.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

KËRKESË

NR. 9801/5, datë 20.11.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës “Xoxi Andoni” dhe hapësirave rreth saj”, shtesa, Fier.

Subjekti kërkuar i shpronësimit është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë që të vihet në dijeni personi i cili preket nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i Rrugës “Xoxi Andoni” dhe hapësirave rreth saj”, shtesa, Fier, për shpronësimin e pasurisë së tij, si dhe për masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 747 794 (shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA E VLERËSIMIT PARAPRAK TË PASURIVE, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS 'XOXI ANDONI' DHE HAPËSIRAVE RRETH SAJ", SHTESA, FIER.

Shënim: çmimi për tokën "truall" është marrë në VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016

Nr	Emër Mbiemër	Zona Kad.	Nr. Pasurisë	Rrethi	Sip. e objektit të banimit	Sip. e truallit (m2)	Çmimi i objektit të banimit	Çmimi i truallit (l/m2)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera Totale (lekë)	Konfirmim nga ZVRPP-ja
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Xhelo Sinan Xhuveli	ZK. 8534	3/205	Fier	—	58	—	12,893.00	—	747.794	747.794	Konfirmuar nga ZVRPP-ja.
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											747,794.00	

KËRKESE

Shtetasja Valentina Shehu kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të shtetasit Hysen Sadik Shehu, i datëlindjes 25.4.1967.

KËRKUESE
Valentina Shehu

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 28 lekë